

BIBLIOTEKA
FEMIJVE

L. 20

ROKASTER

Ferit Lamaj

LEPURI QË BËN SHAKA

- FABULA
- VJERSHA SATIRIKE
- EPIGRAME



41-1
L.20

FERIT LAMAJ

LEPURI QË BËN
SHAKA

- fabula,
- vjersha satirike,
- epigrame



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



IRIQI DHE KËRMILLI

Një kërmill mori një gjemb,
thirr e thirr se po i dhemb.

Jep e merr e bot e bot,
mirëpo gjembin s'e nxjerr dot.

Një iriq që nga një drizë
i thotë: — Hipmë mbi kurriz.

Më kot qahesh, kërmill ti!
Ta nxjerr unë që tani!

Andaj jemi shokë e miq...
— Ç'flet kështu, more iriq!?

Më nxjerr gjembin që më shpon,
por... më ngul një batalion...

DELJA DHE RRODHJA

Rrodhja deles iu qep keq,
mirëpo s'iu ngjit dot, për dreq!

I tha delja : — Lodhesh kot;
nuk e sheh, jam qethur sot!...


BUFI DHE MUSHKONJA

Një ditë mushkonja
tek vinte vërdallë,
sheh bufin. Nuk priti,
i sulet në ballë...

Dhe bufi, si bufi,
i flet me shpoti:
— Zzz përse bën,
pse shet trimëri?!

Se unë, moj mike,
t'të flas ashiqare,
nuk pyes për ty,
je e vogël fare!

Kaluan minutat,
seç u ënjt i mjeri...
I vajti në ndihmë
dhe veterineri,



i tha nja dy fjalë,
ashtu si aqik:
«I madh a i vogël —
armiku është' armik.»




KOTELJA DHE THËNGJILLI

Kotelja pa te hiri
një thëngjill e në çast thirri:

— Shih, moj mamë, sa i mirë,
ç'do të luaj me dëshirë!

— Budallaqe, mos e prek,
ky shkëlqen, por keq të djeg...




LIMA DHE TRARI

Lima hante në një tra...
Qeshte trari: — Ha-ha-ha!
Me sa duket, s'paske punë,
po... a e sheh, moj, kush jam unë?!

S'foli lima asnjë fjalë,
veç punonte me ngadalë.
Shkon një orë, dy e tri,
heshti trari për çudi!

E, ç'të fliste më i mjeri:
...Mbeti sa një fije peri.



DRUJA DHE SËPATA

Çante drunë një sëpatë
bam e bam e me inat...

U bë druja çika-çika
i tha bishtit: — Të rëntë pika!

Po ne bashkë jemi fis,
se ti lis e unë lis!

Ndaj mendohem, bëj çudi:
Mirë hekuri, po ti?!

PËRDERISA...

Dhelprën pyetën një ditë:
— Sa rrush ke ngrënë këtë vit?

U thotë dhelpra: — Uh, sa qesha!
Ç'thoni kështu, moj mikështa!

Përderisa s'më kanë zënë,
as dhe një vesh nuk kam ngrënë...

